



**PROCESVERBAL I DËGJIMIT BUXHETOR
NË LIDHJE ME KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE
(KAB) 2027-2029 – SEÇISHTË**

Procesverbali nga dëgjimi i tretë buxhetor në lidhje me Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027 - 2029 u zhvillua me datën **24.06.2026** duke filluar nga ora 18:00 në SHFMU “Ilaz Thaçi” në fshatin Seçishtë, në të cilin ishin gjithsej 5 pjesëmarrës, prej të cilëve 3 ishin gra dhe 2 burra. Dëgjimin buxhetor e kryesoi Shefja e Kabinetit të Kryetarit znjsh.Liridona Ballazhi e cila i përshëndeti të pranishmit dhe i falënderoi për pjesëmarrjen e tyre, ku për rend të ditës kishin:

- 1. Prezentimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029**
- 2. Diskutimi i hapur**

Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029 e prezantoi Drejtorja për Buxhet dhe Financa, znj.Lindita Ballazhi.

1. Prezentimi i Draft Kornizës Afatmesme Buxhetore

Lindita Ballazhi: Duke u bazuar në Ligjin për Financa Publike dhe Përgjegjësitë, Qeveria e Kosovës gjatë muajit maj të këtij viti ka aprovuar Kornizën Afatmesme të shpenzimeve qeveritare apo KASH-in për periudhën 2027-2029, ku në bazë të Kornizës Afatmesme Buxhetore të shpenzimeve qeveritare lëshoet Qarkorja e parë buxhetore dhe me kufijtë fillestarë në nivel të Kosovës. Me pranimin e Qarkores së parë buxhetore, kemi kufijtë fillestarë buxhetore me të cilat ne bëjmë planifikimin e buxhetit për vitin vijues apo konkretisht për vitin 2027, si dhe parashikimet e hershme për vitin 2028-2029, me ç'rast ne bëjmë hartimin e shpenzimeve duke renditur prioritete kryesore komunale dhe normalisht objektivat të cilat janë të identifikuar në dokumente strategjike komunale. Fazat për zhvillimin e KAB-it komunal dhe afatet kohore janë: në maj Pranimi i Qarkores fillestare Buxhetore 01/2027, Draftimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029, në qershor Konsultimet me Asamblenë Komunale, Mbajtja e Debateve Buxhetore dhe Aprovimi i KAB-it në KPF dhe Kuvend Komunal deri me 30 qershor.

Për vitin buxhetor 2027 Buxheti i Komunës do të jetë 4,564,793.00 €, Ndërkaq tani presim projekt propozimet tuaja për vitin buxhetor 2027.

2. Diskutimi i hapur

Mevludin Kuka: Përshëndetje për të gjithë. I kemi disa kërkesa nga Këshilli i fshatit Seçishtë:

1. Rehabilitimi i rrugës kah Vorbat,
2. Rivitalizimi i kronit në mes të fshatit,
3. Të vazhdohet faza e dytë e kanalit të Llokës në Seçishtë në drejtim të arave.

Lindita Ballazhi: Ne kemi mbajtur procesverbal të këtij debati dhe të gjitha propozime tuaja do të shqyrtohen sërish. Nëse dikush ka ndonjë pyetje tjetër apo propozim, mundeni edhe të më drejtoheni në emailin tim Lindita.ballazhi@rks-gov.net apo edhe kërkesat tuaja ti dërgoni fizikisht tek Qendra për Shërbim me Qytetarë, e më pas ne do t'i shqyrtojmë të gjitha kërkesat, sugjerimet, rekomandimet dhe propozimet tuaja, si ato gjatë këtij dëgjimi, ashtu edhe ato përmes emailit dhe përmes dërgimit te QSHQ. Nëse nuk ka tjetër diskutim apo propozim, e konsideroj të mbyllur dëgjimin buxhetor.

Debati publik përfundoi në orën 18:20.

Procesmbajtësja
Lindita Ballazhi

